



Oda e Fizioterapeutëve të Kosovës  
Komora Fizioterapeuta Kosova  
Kosovo Chamber of Physiotherapists

NR.I PROTOKOLIT 610  
NR I FAQEVE TË BASHKANGJITURA 22  
DATA 22/12/2023 PK 24  
PRISHTINË - KOSOVË

Oda e Fizioterapeutëve të Kosovës / Komora Fizioterapeuta Kosova  
Kosovo Chamber of Physiotherapists

**RREGULLORE PËR  
ANËTARËSIMIN, LICENCIMIN DHE RILICENCIMIN E  
FIZIOTERAPEUTËVE NË OFTK**

Prishtinë, Dhjetor 2023



Adresa: Kompleksi i Q.K.U.K, Klinika e Mjeksisë Fizikale me Rehabilitim, Kati i I-rë, RKS-10000.  
Address: UCCK Complex, Physical Medicine Clinic with Rehabilitation, 1<sup>st</sup> Floor, RKS-10000.  
Tel +383(0) 45 460 551; e-mail [info@oftk-ks.org](mailto:info@oftk-ks.org); web : [www.oftk-ks.org](http://www.oftk-ks.org)

Oda e  
Fizioterapeutëve  
të Kosovës





Oda e Fizioterapeutëve të Kosovës / Komora Fizioterapeuta Kosova  
Kosovo Chamber of Physiotherapists

KUVENDI I ODËS SË FIZIOTERAPEUTËVE TË KOSOVËS, në mbështetje të nenit 19, paragrafit 1 me nënparagrafin 1.1, të Ligjit Nr. 04/L-150 për Odat e Profesionistëve Shëndetësorë, nenit 20 të Statutit të Odës së Fizioterapeutëve të Kosovës në mbledhjen e mbajtur më 22.12.2023 miraton plotësim ndryshimet e:

RR E G U L L O R E P Ë R

ANËTARËSIMIN, RIANËTARËSIMIN, LICENCIMIN DHE RILICENCIMIN E FIZIOTERAPEUTËVE

(Teksti i spastruar me plotësim dhe ndryshime të miratuara sipas Vendimit të Kuvendit të OFTK-së nr.603 dt.22.12.2023)

KREU I - DISPOZITA E PËRGJITHSHME

Neni 1

Qëllimi

I. Me këtë rregullore përcaktohet mënyra dhe kriteret e regjistrimit, licencimit dhe rilicencimit të fizioterapeutëve, si dhe specialistëve të lëmive përkatëse të fizioterapisë. Po ashtu me këtë rregullore përcaktohen kushtet e menaxhimit të regjistrave përkatës në të cilët mbahet evidenca e të gjithë fizioterapeutëve që posedojnë licencën, përfshirë fizioterapeutët të cilët rilicencohen.

II. Kjo rregullore nuk zbatohet për licencimin dhe rilicencimin e fizioterapeutëve me shtetësi të huaj. Licencimi dhe rilicencimi i shtetasve të huaj rregullohet me aktin e veçantë nënligjor të përgatitur nga Ministria e Shëndetësisë dhe të aprovuar nga Qeveria e Kosovës, në përputhje me Nenin 71, paragrafin 3 të Ligjit për Shëndetësinë.

Neni 2  
Përkufizimet

Termet e përdorura në këtë rregullore kanë këtë kuptim:

**Anëtarësim** – procedura e regjistrimit të fizioterapeutit në regjistrin e anëtarëve të OFTK-së

**Regjistri i anëtarëve** – nënkupton regjistrin e OFTK-së i cili përmban të dhënat e të gjithë anëtarëve të regjistruar në OFTK

**Kartela e identifikimit të anëtarit** – nënkupton ID e anëtarësisë me të cilën dëshmohet se personi është anëtar në OFTK.

**Licencimi** – procedura për dhënien e lejes profesionistit shëndetësor që të merret me veprimtari shëndetësore në Kosovë dhe që është i autorizuar ta ushtrojë veprimtarinë shëndetësore në pajtim me ligjet e zbatueshëm në Kosovë

**Ri licencimi** – procedura për vazhdimin e lejes profesionale të profesionistit shëndetësor





## Oda e Fizioterapeutëve të Kosovës / Komora Fizioterapeuta Kosova

### Kosovo Chamber of Physiotherapists

**Komisioni** – nënkupton Komisionin për Licencim të OFTK-së

**KEVP** - nënkupton Komisionin për Edukim të Vazhdueshëm Profesional

**Faksimili** – nënkupton vulën unike të cilën i licencuari e përdorë me rastin e lëshimit të dokumenteve dhe raporteve mjekësore në bashkëngjitje të nënshkrimit personal;

**Shërbimi Profesional i OFTK-së** – nënkupton zyrën administrative të OFTK-së

Termet dhe fjalitë që nuk janë të përfshira në përkufizimet sipas kuptimeve të dhëna në paragrafin 1 të këtij neni, do të interpretohen sipas kuptimeve të përgjithshme gjuhësore dhe njohurive të përgjithshme shkencore dhe teknike.

#### Neni 3

##### Obligimi i anëtarësimit

1. Fizioterapeutët të cilët ushtrojnë ose dëshirojnë të ushtrojnë veprimtarinë e tyre profesionale në territorin e Republikës së Kosovës, janë të obliguar që të regjistrohen dhe anëtarësohen në Odën e Fizioterapeutëve të Kosovës pas kalimit të provimit të Licencimit në Ministrinë e Shëndetësisë.
2. Obligimi mbi anëtarësim për fizioterapeutët e licencuar nga Ministria e Shëndetësisë zbatohet nga viti 2017.
3. Anëtarësia është obligim i fizioterapeutit i caktuar edhe me Ligjin e Odave të Profesionistëve Shëndetësorë
4. Anëtari/ja është i/e obliguar të kryej pagesën e anëtarësisë për ç' do vite sipas Vendimit për taksa administrative të OFTK-së e miratuar në Kuvendin e OFTK-së, deri me datë 31 Mars të vitit përkatës.  
Ndaj anëtarëve të cilët nuk arrijnë të respektojnë afatin e rregullt të pagesës së anëtarësisë sipas pikës 4, obligohen të paguajnë pagesën me afat të parregullt me afat prej 6 muaj në vazhdimësi në përputhje Nenin 43 të kësaj rregullore.
5. Fizioterapeuti i cili ka kaluar provimin e licencimit nga Ministria e Shëndetësisë obligohet që nga data e kalimit të provimit maksimum brenda 1 (një) viti të anëtarësohet në OFTK.
6. Obligimi për anëtarësim përfshinë edhe fizioterapeutët të cilët janë të licencuar nga Ministria e Shëndetësisë.
7. Fizioterapeuti/ja i/e licencuar nga Ministria e Shëndetësisë i/e cili/a nuk është anëtarësuar në Odë brenda afatit të caktuar kohor, i lejohej regjistrimi në Odë vetëm pasi të ketë kryer të gjitha obligimet ndaj Odës.

#### Neni 4

##### Obligimi i Licencimit dhe Rilicencimit

1. Licencimi dhe Ri-licencimi i fizioterapeutit është i detyrueshëm për të gjithë fizioterapeutët për ushtrimin e veprimtarisë fizioterapeutike sipas autorizimeve ligjore.
2. Licencimi/Ri-licencimi është procedurë e veçantë administrative që ka karakter zyrtar dhe publik. Komisioni i licencimit udhëhiqet mbi bazën e parimeve në mbrojtje të interesit të përgjithshëm publik.





## Oda e Fizioterapeutëve të Kosovës / Komora Fizioterapeuta Kosova

### Kosovo Chamber of Physiotherapists

3. Anëtari/ja i cili ka kaluar provimin e licencimit nga Ministria e Shëndetësisë së Republikës së Kosovës obligohet të licencohet e në OFTK-së përmes platformës ONLINE të OFTK-së për licencim.
4. Fizioterapeuti i cili nuk bënë respektimin e afatit të theksuar në Nenin 3 paragrafi 5 të kësaj Rregullore, obligohet ti nënshtrohet testit për licencim brenda organeve të OFTK-së.
5. Për mbajtjen e provimit të licencimit fizioterapeuti është i obliguar të paguaj taksë prej 100EURO.
6. Fizioterapeuti/ja i/e cili/a nuk inicon procedurat e ri-licencimit brenda afatit të përcaktuar kohor prej 2 vite obligohet t'i nënshtrohet provimit të Ri-licencimit të organizuar nga OFTK
7. Fizioterapeuti i licencuar nga Ministria e Shëndetësisë i cili anëtarësohet për herë të parë në Odë obligohet t'i nënshtrohet provimit të Ri-licencimit të organizuar nga OFTK për ri-licencim.

#### Neni 5

##### Komisioni për Licencim

1. Komisioni për Licencim është komision i përhershëm i OFTK-së përgjegjës në ushtrimin e këtyre kompetencave dhe përgjegjësi:
  - 1.1. Mirëmbajtjen e regjistrave zyrtarë të anëtarëve të OFTK-së;
  - 1.2. I rekomandon Këshillit Drejtues të paraqesë në Kuvend ndryshimin e akteve ligjore me të cilat rregullohet fushë veprimtaria e këtij Komisioni;
  - 1.3. Vendos në shkallë të parë mbi përmbushjen e kushteve për anëtarësim, ri anëtarësim, licencimin, ri licencimin e fizioterapeutëve dhe njohjen e licencave të fizioterapisë të lëshuara jashtë vendit brenda kompetencave të veta;
  - 1.4. Revokimin e përkohshëm apo të përhershëm të licencës të fizioterapeutëve pas vendimit të Këshillit Etik (në rast ankese pas përfundimit të shqyrtimit të ankesës nga Gjyqi i Nderit);
  - 1.5. Fshirjen e anëtarit nga regjistrat e anëtarësisë me rast të mospagesës së anëtarësisë brenda afateve kohore të përcaktuara në Statut dhe kësaj Rregullore.
  - 1.6. Bashkëpunimin me organet e tjera në përmbushjen e kompetencave të OFTK-së, të cilat janë në përputhje me fushëveprimin e këtij komisioni.

## KREU II – REGJISTRIMI (ANËTARËSIMI) I FIZIOTERAPEUTËVE

#### Neni 6

##### Regjistri i anëtarëve

1. Komisioni për Anëtarësim, Licencim dhe Ri-licencim është organ kompetent i Odës i cili bën regjistrimin dhe mirëmbanë regjistrat e fizioterapeutëve që anëtarësohen në Odë.





## Oda e Fizioterapeutëve të Kosovës / Komora Fizioterapeuta Kosova

### Kosovo Chamber of Physiotherapists

2. Komisioni me rastin e regjistrimit të fizioterapeutit në Odë, vlerëson përmbushjen e kushteve të përcaktuar me këtë rregullore për fitimin e statusit të anëtarit të Odës.
3. Vetëm pas verifikimit të plotësimit të kushteve nga ana e Komisionit për Licencim, parashtruesi i formularit për anëtarësim regjistrohet në regjistrin e anëtarëve të Odës, që përndryshe përbën regjistrin e profesionistëve që ushtrojnë veprimtarinë e tyre në territorin e Republikës së Kosovës.
4. Komisioni për Licencim mban lloje të regjistrave të anëtarëve:
  - 4.1 Regjistri i anëtarëve të OFTK-së shtetas të Kosovës,
  - 4.2 Regjistri i anëtarëve të Anëtarësuar dhe Licencuar në OFTK
  - 4.3 Regjistri i anëtarëve të Ri-licencuar në OFTK.
  - 4.4 Regjistri i Anëtarëve të fshirë nga regjistri i OFTK-së si pasojë e mosrespektimit të Legjislacioni të OFTK-së,
  - 4.5 Regjistri i Anëtarëve me çregjistrim të vullnetshëm,
  - 4.6 Regjistri i Anëtarëve të pensionuar,
  - 4.7 Regjistri i Anëtarëve me licencë të Revokuar,
  - 4.8 Regjistri i Anëtarëve të pajisur me Licencë Dublikate,
  - 4.9 Regjistri i Anëtarëve të pajisur me Licencë me ndryshime të të dhënave.
5. Kur Komisioni për Licencim merr vendim për regjistrimin dhe anëtarësimin e anëtarit në regjistrin e anëtarëve të OFTK-së, Shërbimi Profesional regjistron menjëherë të dhënat e fizioterapeutit në regjistrin.
  - 5.1 Regjistri i anëtarëve përmban këto të dhëna:
    - 5.1.1 Nr. Rendor;
    - 5.1.2 Emrin dhe mbiemrin;
    - 5.1.3 Numrin personal
    - 5.1.4 Vendi dhe data e lindjes.
    - 5.1.5 Nr. licencës (nëse e posedon);
    - 5.1.6 Datën e regjistrimit.
    - 5.1.7 Nr. Anëtarësimit
    - 5.1.8 Data e Licencimit
    - 5.1.9 Data e skadimit të licencës
    - 5.1.10 Të dhënat e tjera personale të identifikimit të anëtarit dhe anëtarësisë së tij/saj në OFTK.

#### Neni 7

#### Kriteret për anëtarësim të shtetasve të Kosovës

1. Kriteret për anëtarësim në OFTK janë:
  - 1.1. Të jetë shtetas i Republikës së Kosovës;
  - 1.2. Të ketë dhënë provimin profesional të licencës apo të ketë licencë;





## Oda e Fizioterapeutëve të Kosovës / Komora Fizioterapeuta Kosova

### Kosovo Chamber of Physiotherapists

- 1.3. Të jetë i diplomuar si fizioterapeutë në ndonjërin nga institucionet e akredituara të arsimit të lartë në vend, apo të ketë vendimin e nostrifikimit nga Ministria e Arsimit të diplomës së lëshuar jashtë shtetit të Kosovës;
- 1.4. Të ketë paguar taksën administrative për anëtarësim.

#### Neni 8

##### Procedura e Regjistrimit për Anëtarësim

1. Procedura e regjistrimit të aplikuesit/es iniciohet me aplikim ONLINE në platformën e OFTK-së të cilën përmbush të gjitha të dhënat e tij/saj.
2. Aplikuesi/ja pas aplikimit në platformën ONLINE, duhet fizikisht të plotësoj formularin për aplikim dhe së bashku me të dorëzoj këto dokumente origjinale:
  - 2.1. Formularin për aplikim,
  - 2.2. Kopjen e letërnjoftimit,
  - 2.3. Ekstraktin e lindjes,
  - 2.4. Kopjen e noterizuar të diplomës së studimeve ose vërtetimit (certifikata e diplomës e noterizuar), në rast të studimeve jashtë vendit kopjen e noterizuar të vendimit të nostrifikimit të diplomës nga MASHI,
  - 2.5. Kopja e noterizuar e licencës ose certifikata e provimit të licencës,
  - 2.6. Dy fotografi të formatit,
  - 2.7. Pagesa e taksës administrative të anëtarësisë,
  - 2.8. Anëtari obligohet të përmbush dhe t'i sjell të gjitha dokumentet e nevojshme në zyret e Shërbimit Administrativ të OFTK-së për përmbushjen dhe plotësimin e dosjes së tij/saj fizike
3. Anëtari/ja i regjistruar në regjistrat e OFTK obligohet që në profilin e tij privat të platformës ONLINE të OFTK-së të bëjë ri regjistrimin e të dhënave të tij/saj personale në çdo rast ndryshimi brenda afatit prej 30 ditësh nga dita e ndryshimit të dhënave.

#### Neni 9

##### Anëtarësimi i fizioterapeutëve që ushtrojnë veprimtarinë e tyre jashtë Republikës së Kosovës

1. Fizioterapeutët me shtetësi të Republikës së Kosovës të cilët ushtrojnë veprimtarinë shëndetësore jashtë territorit të Republikës së Kosovës dhe që shprehin vullnetin të regjistrohen dhe anëtarësohen në Odë, mund të paraqesin kërkesën e tyre për regjistrim në pajtim me kushtet siç janë paraparë me dispozitat e kësaj Rregullore, përkitazi me regjistrimin dhe anëtarësimin e fizioterapeutëve vendor.

#### Neni 10

##### Kriteret për anëtarësim të fizioterapeutëve që nuk kanë shtetësi të Kosovës

1. Fizioterapeutët që kanë shtetësi të huaj dhe që ushtrojnë veprimtarinë e tyre brenda territorit të Republikës së Kosovës, janë të obliguar që të anëtarësohen në Odë.





## Oda e Fizioterapeutëve të Kosovës / Komora Fizioterapeuta Kosova

### Kosovo Chamber of Physiotherapists

2. Për aplikuesit të cilët nuk kanë shtetësi të Kosovës aplikohen këto kritere për anëtarësim:
  - 2.1. Të jetë i pajisur me leje qëndrim në Kosovë,
  - 2.2. Kopjen e noterizuar të diplomës së studimeve ose vërtetimin (certifikata e diplomës e noterizuar), në rast të studimeve jashtë vendit kopjen e noterizuar të vendimit të nostrifikimit të diplomës nga MASHT (ose që është në proces nostrifikimit),
  - 2.3. Të ketë kopje të noterizuar të licencës së punës të lëshuar nga shteti origjinës e përkthyer nga përkthyesi zyrtar në Gjuhën Shqipe, ose të jetë i pajisur me leje pune nga organi kompetent nëse posedohet,
  - 2.4. Të ketë paguar taksën administrative për anëtarësim të miratuar nga Kuvendi i Odës.
3. Për fizioterapeutët të cilët nuk kanë shtetësi të Kosovës që aplikojnë për anëtarësim në OFTK, duhet të dorëzojnë këto dokumente:
  - 3.1. Aplikacionin,
  - 3.2. Kopja e noterizuar e lejes së qëndrimit në Kosovë,
  - 3.3. Kopja e noterizuar e licencës së punës nga shteti, shtetas i të cilit është ose kopja e noterizuar e lejes së punës për ushtrimin e profesionit të fizioterapeutit në Kosovë nga MSH nëse posedohet,
  - 3.4. Kopjen e noterizuar të diplomës së studimeve ose vërtetimin (certifikata e diplomës e noterizuar), në rast të studimeve jashtë vendit kopjen e noterizuar të vendimit të nostrifikimit të diplomës nga MASHT,
  - 3.5. Pagesa e taksës administrative për anëtarësim

#### Neni 11

#### Fillimi i procedurës për anëtarësim

1. Fizioterapeuti inicion procedurën e anëtarësimit përmes parashtrimit të aplikacionit dhe dokumentacionit Shërbimit Profesional të OFTK-së përmes sistemit online nga OFTK.
2. Shërbimi Profesional një kopje të aplikacionit të nënshkruar dhe vulosur nga zyrtari i OFTK-së i konfirmon online aplikuesit.
3. Shërbimi Profesional i OFTK-së aplikacionin për licencim së bashku me dokumentacionin i procedon te Komisioni për Anëtarësim Licencim dhe Ri-licencim (KALR).
4. Komisioni për anëtarësim, licencim dhe ri-licencim do të shqyrtojë dosjen e tillë dhe për regjistrimin dhe anëtarësimin e parashtruesit nxjerrë vendim në afat prej nga 15 - 30 (pesëmbëdhjetë - tridhjetë) ditëve nga dita e dorëzimit të formularit.
5. Me rastin e nxjerrjes së vendimit mbi regjistrim dhe anëtarësim, Komisioni për licencim mund që:
  - 5.1. Aprovojë regjistrimin dhe anëtarësimin e parashtruesit;
  - 5.2. Të refuzojë regjistrimin dhe anëtarësimin e parashtruesit për shkak të mosplotësisë së kushteve sipas kësaj rregulloreje; apo
  - 5.3. Të refuzojë regjistrimin e parashtruesit për shkak të ekzekutimit të masës disiplinore të heqjes nga regjistri.





## Oda e Fizioterapeutëve të Kosovës / Komora Fizioterapeuta Kosova

### Kosovo Chamber of Physiotherapists

6. Në rast se aprovohet kërkesa e parashtruesit/es për anëtarësim në OFTK, ndaj anëtarit/es të ri të OFTK-së do të lëshohet fletënjoftim me sqarim të gjitha te drejtave dhe detyrimet e tyre si profesionistë shëndetësor dhe anëtarë të OFTK-së
7. Komisioni për licencim mundet që gjatë shqyrtimit të kërkojë nga parashtruesi të bëjë plotësimin e dokumentacionit që kërkohet për regjistrim, duke i dhënë afat parashtruesit që plotësimin e tillë ta bëjë në afat prej 7 (shtatë) ditëve nga dita e njoftimit.
8. Pala e pakënaqur ndaj vendimit të Komisionit për licencim sipas paragrafit 5 nënparagrafi 5.2 të këtij neni, mund të parashtrojë ankesë pranë Këshillit Drejtues të Odës në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga data e pranimit të vendimit.
9. Dispozitat e këtij neni do të zbatohen përshtatshmërisht ndaj fizioterapeutit me shtetësi të huaj.

#### Neni 12

##### Çregjistrimi i vullnetshëm

1. Anëtari i cili shprehë vullnetin për çregjistrimin nga anëtarësimi në Odë, duhet ta paraqes kërkesën për çregjistrim nga OFTK ne platformën ONLINE në të cilën duhet të paraqes arsyet e kërkesës për çregjistrim.
  - 1.1. Kërkesës për çregjistrim të vullnetshëm i bashkangjitet letërënjoftimi personal i/e anëtarit/es së bashku me licencën origjinale të anëtarit, kartelën e anëtarësisë së OFTK-së dhe faksimilin.
2. Çregjistrimi nga Regjistri i Anëtarësisë nënkupton heqjen dorë nga ushtrimi i veprimtarisë fizioterapeutike.
3. Komisioni për Anëtarësim, Licencim dhe Rilicencimin e Fizioterapeutëve ndaj kërkesës për çregjistrim ka të drejtën e marrjes së vendimit për aprovimin ose refuzimin e kërkesës.
4. Anëtari/ja i/e cili aplikon për çregjistrim të vullnetshëm, duhet të përmbyll dhe përmbush të gjithë obligimet të cilat ka drejt OFTK.
5. Ndaj vendimit të Komisionit me të cilin refuzohet kërkesa për çregjistrim, pala e pakënaqur mund ta paraqesë ankesë pranë Këshillit Drejtues të Odës, në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga dita e pranimit të vendimit
6. Anëtari/ja i çregjistruar me vullnet nga anëtarësia e OFTK-së me rastin e kërkesës për ri-anëtarësim në OFTK obligohet të paguaj retrograd për të gjitha vitet e humbura nga anëtarësia në OFTK duke përfshirë vitet nga çregjistrimi i anëtarit/es deri në vitin e parashtrimit të kërkesës për rianëtarësim.

#### Neni 13

##### Kartela e Identifikimit të anëtarit të OFTK-së

1. Nëse Komisioni për Licencim miraton kërkesën për anëtarësim në OFTK, të anëtarësuarit i lëshohet kartela identifikuese e anëtarësisë me logon e Odës së Fizioterapeutëve të Kosovës e cila përmban së paku këto të dhëna:
  - 1.1. Emri dhe mbiemri;

Adresa: Kompleksi i Q.K.U.K, Klinika e Mjeksisë Fizikale me Rehabilitim, Kati i I-rë, RKS-10000.

Address: UCCK Complex, Physical Medicine Clinic with Rehabilitation, 1<sup>st</sup> Floor, RKS-10000.

Tel +383(0) 45 460 551; e-mail [info@oftk-ks.org](mailto:info@oftk-ks.org); web : [www.oftk-ks.org](http://www.oftk-ks.org)

Oda e  
Fizioterapeutëve  
të Kosovës







**Oda e Fizioterapeutëve të Kosovës / Komora Fizioterapeuta Kosova**  
**Kosovo Chamber of Physiotherapists**

- 1.2. Nr. personal,
- 1.3. Numri i Licencës
- 1.4. Nr. Anëtarësisë;
- 1.5. Data e licencimit dhe skadimit të Licencës
- 1.6. Të dhëna tjera të cilat mund të përcaktohen sipas Këshillit Drejtues të OFTK-së.
2. Kartela e anëtarësisë është pronë e odës dhe si e tillë duhet t'iu dorëzohet organeve kompetente të odës me rastin e skadimit të saj, në rast të çregjistrimit nga regjistri i anëtarëve apo edhe revokimit të Licencës së anëtarit/es.
3. Në rast të humbjes së kartelës, anëtari i OFTK-së njofton me shkrim Komisionin për humbje duke e arsyetuar atë.
4. Komisioni lëshon kartelën e re, pas licencimit të anëtarit.

**Neni 14**  
**Përmbajtja e aplikacionit**

1. Aplikacioni për anëtarësimin përbëhet nga dy pjesë: Pjesa e parë plotësohet nga aplikuesi dhe përmban të dhënat personale të tij:
  - 1.1. Emri dhe mbiemri;
  - 1.2. Nr. Licencës (për të licencuarit nga Ministria e Shëndetësisë)
  - 1.3. Certifikata se dhënies së Provimit
  - 1.4. Vendi dhe data e lindjes;
  - 1.5. Adresa e vendbanimit;
  - 1.6. Institucioni në të cilin ka diplomuar, data e diplomimit dhe nr. Diplomës;
  - 1.7. Lloji i specializimit dhe data e specializimit (vetëm për specialistët)
  - 1.8. Numri i telefonit;
  - 1.9. Adresa valide e e-mail;
  - 1.10. Nënshkrimi;
  - 1.11. Deklaratën se me nënshkrimin e aplikuesit e gjithë përgjegjësia për saktësinë e të dhënave është e tij.
2. Pjesa e dytë përmban të dhënat mbi dokumentacionin e dorëzuar në OFTK dhe nënshkrimin e zyrtarit të OFTK-së i cili ka pranuar aplikacionin. Kjo pjesë plotësohet nga zyrtari i OFTK përmes sistemit elektronik nga OFTK.

**Neni 15**  
**Regjistrat e anëtarëve**

1. Komisioni për Licencim mban dy lloje të regjistrave të anëtarëve:
  - 1.1. Regjistri i anëtarëve të OFTK-së shtetas të Kosovës,
  - 1.2. Regjistri i anëtarëve të OFTK-së të cilët nuk janë shtetas të Kosovës.





## Oda e Fizioterapeutëve të Kosovës / Komora Fizioterapeuta Kosova

### Kosovo Chamber of Physiotherapists

#### Neni 16

#### Përmbajtja e regjistrit

1. Kur Komisioni për Licencim merr vendim për regjistrimin dhe anëtarësimin e anëtarit në regjistrin e anëtarëve të OFTK-së, Shërbimi Profesional regjistron menjëherë të dhënat e fizioterapeutit në regjistër.
2. Regjistri i anëtarëve përmban këto të dhëna:
  - 2.1. Nr. Rendor;
  - 2.2. Emrin dhe mbiemrin;
  - 2.3. Nr. licencës (nëse e posedon);
  - 2.4. Datën e regjistrimit.
  - 2.5. Nr. Anëtarësimit

#### Neni 17

#### Fshirja nga regjistri i anëtarësisë

1. Komisioni për Licencim merr vendim për fshirjen nga regjistri i anëtarësisë në këto raste:
  - 1.1. Me revokimin e përhershëm ose të përkohshëm të licencës nga Këshilli Etik, ose vendimit nga Gjyqi i Nderit në rast të ankesës;
  - 1.2. Me kërkesën e anëtarit të Odës;
  - 1.3. Në rast të vdekjes së anëtarit;
  - 1.4. Fshirjen nga regjistri i anëtarëve si shkak i mospagesës së anëtarësisë vjetore të OFTK-së.
  - 1.5. Me rastin e skadimit të Licencës së Punës të OFTK-së në përputhje me legjislacionin e OFTK-së.
  - 1.6. Me rastet e ekzekutimit të vendimeve të marra nga organet etike të OFTK-së.
2. Anëtari nuk ka të drejtë ankese ndaj vendimit të marr nga Komisioni për Anëtarësim, Licencim dhe Ri-licencim i OFTK-së për fshirje nga regjistri si shkak i mospagesës së anëtarësisë ndaj OFTK-së
3. Anëtarët të cilët nuk përmbushin obligimin mbi anëtarësimin vjetor edhe 6 muaj pas afatit të përcaktuar nga OFTK, automatikisht konsiderohen të pezulluar nga anëtarësimi.
4. Fizioterapeuti i fshirë nga regjistri i anëtarësisë njëherë, me rastin e riaplikimit për rianëtarësim paguan taksë shtesë sipas shumës së caktuar me vendim të kuvendit duke përfshirë pagesë të taksave dhe të gjitha viteve e humbura të anëtarësisë në OFTK.

#### Neni 18

#### E drejta e ankesës.

1. Fizioterapeuti i fshirë nga regjistri i anëtarësisë ka të drejtë ankese ndaj vendimit të Komisionit në Këshill Drejtues (brenda 15 ditëve nga pranimi i vendimit), në përjashtim të rasteve të cilat nuk parashihet e drejta e ankesës.

Adresa: Kompleksi i Q.K.U.K, Klinika e Mjeksisë Fizikale me Rehabilitim, Kati i I-rë, RKS-10000.

Address: UCCK Complex, Physical Medicine Clinic with Rehabilitation, 1<sup>st</sup> Floor, RKS-10000.

Tel +383(0) 45 460 551; e-mail [info@oftk-ks.org](mailto:info@oftk-ks.org); web : [www.oftk-ks.org](http://www.oftk-ks.org)

Oda e  
Fizioterapeutëve  
të Kosovës





## Oda e Fizioterapeutëve të Kosovës / Komora Fizioterapeuta Kosova

### Kosovo Chamber of Physiotherapists

#### Neni 19

#### Ri anëtarësimi i fizioterapeutit.

1. Fizioterapeuti i cili është fshirë nga regjistri anëtarësimi, aplikon për rianëtarësim pas përfundimit të shkaqeve për të cilat është fshirë nga regjistri.
2. Fizioterapeuti i cili aplikon për rianëtarësim në OFTK obligohet të përmbush fillimisht të gjitha kushtet dhe kriteret për rianëtarësim në OFTK përfshi këtu obligimet ndaj Odës dhe pagesa retrograd e të gjitha viteve të humbura.
3. Ri anëtarësimi bëhet me parashtrimin e kërkesës në komision duke theksuar shkaqet se pse është fshirë nga regjistri dhe nëse të njëjtat janë eliminuar.
4. Kërkesa për rianëtarësim i drejtohet Komisionit për Anëtarësim, Licencim dhe Ri-licencim të Fizioterapeutëve.
5. Komisioni ndaj kërkesës për rianëtarësim ka të drejtë të marrjes se vendimit aprovues ose refuzues.
6. Kundër vendimit të Komisionit ndaj kërkesës për rianëtarësim anëtarit ka të drejtë ankese në afat prej 8 ditësh tek Këshilli Drejtues i OFTK-së.
7. Pas aprovimit të kërkesës së anëtarit për rianëtarësim, dosja e anëtarit për rianëtarësim kalon në fazat e mëtejme të Komisionit të EVP-së dhe Komisionit për Anëtarësim Licencim dhe Ri-licencim.

#### Neni 20

#### Anëtarësimi dhe Ri-licencimi i Fizioterapeutëve të Licencuar nga Ministria e Shëndetësisë

1. Fizioterapeuti/ja i licencuar për herë të parë nga Ministria e Shëndetësisë me rastin e parashtrimin të kërkesës për Ri-licencim në OFTK obligohet të anëtarësohet në OFTK.
2. Fizioterapeuti/ja obligohet të paguaj taksën e anëtarësimin në OFTK, duke përfshirë pagesën për anëtarësim + retrograd të gjithë vitet e humbura të anëtarësimi në OFTK-së.
3. Fizioterapeuti/ja i licencuar për herë të parë nga Ministria e Shëndetësisë i/e cili/a fillon procedurat e Ri-licencimit për herë të parë në OFTK vetëm pas kryerjes së obligimeve ndaj Odës për anëtarësim në OFTK.
4. Fizioterapeuti i licencuar nga Ministria e Shëndetësisë pas aprovimit të kërkesës për anëtarësim nga Komisioni obligohet ti nënshtrohet provimit të Ri-licencimit të organizuar nga OFTK.
5. Ndaj fizioterapeutit/es Licenca lëshohet me afat kohor 5 vjeçar duke filluar afati kohor nga data e mbajtjes së mbledhjes së Komisionit të ALR.

#### KREU III - LICENCIMI DHE RILICENCIMI I FIZIOTERAPEUTËVE

#### Neni 21

#### Inicimi i procedurës për licencim dhe rilicencim

1. Fizioterapeuti inicion procedurën e licencimit dhe rilicencimit përmes parashtrimin të kërkesës në sistemin elektronik të aplikacionit dhe dokumentacionit Shërbimit Profesional të OFTK-së.





## Oda e Fizioterapeutëve të Kosovës / Komora Fizioterapeuta Kosova

### Kosovo Chamber of Physiotherapists

- 1.1. Aplikimi për Licencim i anëtarit në mënyrë automatike inicion aplikimin për pajisje me faksimil të anëtarit.
- 1.2. Procedura për rilicencim fillohet 30 ditë para skadimit të afatit të licencës duke dorëzuar aplikacionin në KEVP për valorizim të pikëve kredituese
- 1.3. Anëtari me licencë të skaduar të punës nuk ka të drejtën e kryerjeve të shërbimeve nga OFTK pa vazhduar procedurat e ri-licencimit.
2. Shërbimi Profesional një kopje të aplikacionit të nënshkruar dhe vulosur nga zyrtari i OFTK-së i dorëzon aplikuesit përmes sistemit elektronik.
3. Shërbimi Profesional i OFTK-së aplikacionin për licencim pas validimit së bashku me dokumentacion i procedon te komisioni për Anëtarësim, Licencim dhe Ri-licencim.
4. Aplikacionet për rilicencim procedohen në komisionin për edukim të vazhdueshëm profesional për valorizimin e pikëve kredituese të fizioterapeutëve si fazë e parë e procedurës së Ri-licencimit në OFTK
  - 4.1. KEVP lëshon vendim për aprovimin e valorizimit të pikëve kredituese.
  - 4.2. Dosja e aplikuesit për rilicencim pas lëshimit të vërtetimit mbi valorizimin e pikëve, i procedohet Komisionit për vendosje.

#### Neni 22

##### Kriteret dhe dokumentacioni për licencim të fizioterapeutëve/ specialistëve të fizioterapisë.

1. Kriteret për licencimin janë:
  - 1.1. Plotësimi i formularit për aplikim,
  - 1.2. Letërnjoftimi – me të cilin dëshmohet shtetësia e Republikës së Kosovës,
  - 1.3. Certifikata e provimit profesional për licencë – me të cilën dëshmohet dhënia e provimit profesional për licencë,
    - 1.3.1. Për specialistët edhe certifikata e provimit specialistik
  - 1.4. Deklarata nën betim se nuk ka ndryshim të dhënave nga dosja e paraqitur për anëtarësim,
  - 1.5. Pagesa e taksës administrative për licencë.

#### Neni 23

##### Kriteret dhe dokumentacioni për rilicencim të fizioterapeutëve/specialistëve të fizioterapisë

1. Kriteret për rilicencim janë:
  - 1.1. Plotësimi i aplikacionit,
  - 1.2. Letërnjoftimi – me të cilin dëshmohet shtetësia e Republikës së Kosovës,
  - 1.3. Kartela e identifikimit e anëtarësisë në OFTK me të cilën dëshmohet anëtarësia në Odën e Fizioterapeutëve të Kosovës,
  - 1.4. Të ketë vendimin e KEVP mbi valorizimin e pikëve në përputhje me rregulloren për edukim të vazhdueshëm profesional,
    - 1.4.1. Në përjashtim të rasteve kur anëtari/ja nuk arrin përmbushjen e kriterëve për valorizimin e pikëve kredituese nga KEVP, kërkohet vlerësuesi nga Komisioni i Provimit të Ri-licencimit të OFTK-së.





## Oda e Fizioterapeutëve të Kosovës / Komora Fizioterapeuta Kosova

### Kosovo Chamber of Physiotherapists

- 1.5. Të dorëzojë kopjen e licencën (Licencën origjinale në rastet kur fizioterapeuti inicion procedurën e ri-licencimit me vonesë)
- 1.6. Deklarata nën betim se nuk ka ndryshim të dhënave nga regjistri i anëtarësisë apo nga dosja e licencimit (përfshirë afatit të licencës),
- 1.7. T'i ketë paguar taksat administrative për anëtarësim,
- 1.8. Ta ketë paguar taksën administrative për ri-licencim brenda afatit të përcaktuar në faturën e lëshuar ndaj tij/saj.
- 1.9. Origjinali i licencës së skaduar dorëzohet fizikisht në OFTK me rastin e pranimit të licencës së re, në rast se anëtarë nuk dorëzojnë Licencën e vjetër, i njëjti nuk do të pajiset me Licencën e re

#### Neni 24

##### Lirimi i anëtarëve për Ri-licencim nga pagesa e anëtarësisë vjetore dhe taksës për Ri-licencim.

1. Anëtarët e OFTK-së me gjendje të përkeqësuar shëndetësore (sëmundje malinje) lirohen nga obligimi i pagesës së anëtarësisë vjetore të OFTK-së dhe taksës për Ri-licencim.
2. Lirimi nga pagesa e anëtarësisë vjetore nuk mund të behet me shume se një herë, në përjashtim të rasteve të vendimit nga Këshilli Drejtues të OFTK-së.
3. Anëtarë i Odës, respektivisht i autorizuar për të drejtën e lartëcur, i paraqet Komisionit një kërkesë me shkrim për lirim nga pagesa e anëtarësisë vjetore dhe taksës për ri-licencim. Kërkesës i bashkëngjitet dokumentacioni përkatës me të cilin vërtetohet baza për të drejtën e njohur nga Komisioni (kopje të dokumenteve mjekësore).
4. Kërkesa për lirim nga pagesat e lartëcur duhet të dorëzohet:
  - Për lirim nga pagesa e anëtarësisë në periudhën e afatit të rregullt kohorë për pagesën e anëtarësisë vjetore të OFTK-së
  - Për lirim nga taksë e Ri-licencimit në afatin e caktuar kohorë të aplikimit për Ri-licencim të anëtarit

#### Neni 25

##### Dosja fizike e të licencuarit/rilicencuarit në OFTK

1. Me rastin e aplikimit për licencim, anëtarë i OFTK-së nuk sjell dokumentacionin i cili ekziston në dosjen e tij të OFTK-së.
2. Fizioterapeuti me rastin e tërheqjes së licencës, sjell në kopje fizike të gjithë dokumentacionin me të cilin është aplikuar online.

#### Neni 26

##### Rilicencimi i fizioterapeutëve të cilët nuk plotësojnë kriteret e EVP për rilicencim

1. Anëtarë i OFTK-së i cili nuk ka arritur pikët kredituese prej 100 pikësh për valorizim nga KEVP me hyrjen e vendimit në fuqi, anëtarit/es i propozohet nënshtrimi në Provim të Ri-licencimit të organizuar nga OFTK.





## Oda e Fizioterapeutëve të Kosovës / Komora Fizioterapeuta Kosova

### Kosovo Chamber of Physiotherapists

2. Provimi për Rilicencim organizohet nga Komisioni i posaçëm i emëruar si Komisioni për Ri-licencim nga Kuvendi i Odës .
3. Anëtarët e Komisionit duhet të kenë të përfunduara studime pasdiplomike (për personat që kanë përfunduar jashtë shtetit nevojitet nostrifikimi i diplomës nga MASHT), dhe të paktën njëri prej tyre duhet të ketë titullin e profesorit universitar.
4. Anëtarët e Komisionit për Provimin e Ri-licencimit të Fizioterapeutëve në kuadër të OFTK-së formojnë bankën e pyetjeve të cilat anëtarët për provim do të ju nënshtrohen.
5. Për paraqitjen e Provimit të Ri-licencimit anëtari është i obliguar t'i kryej pagesën e taksave të nevojshme për Provimin të Ri-licencimit dhe të Ri-licencimit sipas Vendimit për Taksa Administrative për Shërbimet e OFTK-së.
6. Fizioterapeuti/ja i/e cili/a pas skadimit të licencës së tyre nuk i'u është nënshtuar procesit të ri-licencimit në kohëzgjatje prej 2 viteve, me rastin e ri-licencimit i nënshtrohen provimit të ri-licencimit.
7. Anëtari njoftohet së paku 15 ditë para datës së caktuar për provim.
8. Kërkesës për provim i bashkohet vërtetimi i KEVP për mosplotësim të kriterit për rilicencim së bashku me pagesën e taksës administrative për provim.
9. Provimi realizohet me shkrim ose verbal. Komisioni i Ri-licencimit lëshon Vlerësues me "kaloj" ose "nuk kaloj" e cila konstaton kalimin apo jo të anëtarit ndaj provimit të realizuar. Dosja e kandidatit është konfidenciale.
10. Komisioni ka diskrecionin që për shkaqe të arsyeshme të njëjtin ta organizojë edhe online.
11. Shërbimi Administrativ përcjell dosjen e anëtarit i cili kalon provimin, së bashku me Vlerësimin nga Komisioni për Ri-licencim i OFTK-së tek Komisioni për Anëtarësim, Licencim dhe Ri-licencim.
12. Nëse kandidati vlerësohet në përfundim të testimit me shkrim me "nuk kaloj", për vazhdimin e procedurës së Ri-licencimit në OFTK propozohet t'i nënshtrohet riprovimit.
13. Çështjet tjera rreth provimit rregullohen me vendim të Këshillit Drejtues.
14. Në riprovim anëtari paguan taksë të re administrative për riprovim të provimit të ri-licencimit të përcaktuar sipas vendimit për taksa administrative të OFTK-së.

#### Neni 27

#### Mosnënshtimi i anëtarit/es në Provim të Ri-licencimit

1. Ndaj anëtarit i cili nuk arrin kreditimin prej 100 pikë nga Komisioni i EVP-së për valorizim dhe nuk i nënshtrohet Provimit të Ri-licencimit brenda afatit të caktuar në këtë Rregullore për mbajtjen e Provimit merret vendim për fshirje nga anëtarësia.





## Oda e Fizioterapeutëve të Kosovës / Komora Fizioterapeuta Kosova

### Kosovo Chamber of Physiotherapists

2. Anëtari/ja i/e fshirë sipas paragrafit 1 të këtij Neni obligohet t'i nënshtrohet procedurave të rianëtarësimit në OFTK.

#### Neni 28

#### Përmbajtja e aplikacionit për licencim/rilicencim

1. Aplikacioni për licencimin, e fizioterapeutëve përbëhet nga dy pjesë.
2. Pjesa e parë plotësohet nga aplikuesi dhe përmban të dhënat personale të tij:
  - 2.1. Emri dhe mbiemri;
  - 2.2. Emri i prindit
  - 2.3. Nr. i certifikatës së provimit;
  - 2.4. Vendi dhe data e lindjes;
  - 2.5. Adresa e vendbanimit;
  - 2.6. Institucioni në të cilin ka diplomuar, data e diplomimit dhe nr. Diplomës;
  - 2.7. Numri i telefonit;
  - 2.8. Adresa e e-mail;
  - 2.9. Nënshkrimi;
  - 2.10. Deklaratën se me nënshkrimin e aplikuesit e gjithë përgjegjësia për saktësinë e të dhënave është e tij.
3. Aplikacioni për ri-licencimin e fizioterapeutëve, specialistëve përmban të dhënat:
  - 3.1. Pjesa e parë plotësohet nga aplikuesi dhe përmban të dhënat personale të tij;
  - 3.2. Emri dhe mbiemri;
  - 3.3. Emri i Prindit
  - 3.4. Nr. Licencës;
  - 3.5. Vendi dhe data e lindjes;
  - 3.6. Adresa e vendbanimit;
  - 3.7. Institucioni në të cilin ka diplomuar, data e diplomimit dhe nr. Diplomës;
  - 3.8. Lloji i specializimit dhe data e specializimit (vetëm për specialist);
  - 3.9. Numri i telefonit;
  - 3.10. Adresa e e-mail;
  - 3.11. Nënshkrimi;
  - 3.12. Deklaratën se me nënshkrimin e aplikuesit e gjithë përgjegjësia për saktësinë e të dhënave është e tij.
4. Pjesa e dytë përmban të dhënat mbi dokumentacionin e dorëzuar në OFTK dhe nënshkrimin e zyrtarit të OFTK-së i cili ka pranuar aplikacionin. Kjo pjesë plotësohet nga zyrtari i OFTK-së. Një kopje elektronike të tij e pranohet aplikuesi.





## Oda e Fizioterapeutëve të Kosovës / Komora Fizioterapeuta Kosova

### Kosovo Chamber of Physiotherapists

#### Neni 29

##### Afati kohor i shqyrtimi të kërkesës

1. Komisioni për Licencim jo më vonë se 30 ditë nga pranimi i kërkesës për licencim ose rilicencim është i obliguar të shqyrtojë atë dhe të vendosë në lidhje me të.

#### Neni 30

##### Vendimi për miratimin e kërkesës

1. Komisioni për Licencim e miraton kërkesën në rast se janë të plotësuara të gjitha kushtet e parapara me këtë rregullore.

#### Neni 31

##### Vendimi për refuzimin e kërkesës

1. Në rastet kur aplikacioni përmban mangësi në plotësimin e dokumentacionit, komisioni mund të caktojë afat shtesë jo më shumë se 7 ditë nga shqyrtimi i aplikacionit për plotësimin e lëndës.
2. Nëse brenda këtij afati aplikuesi nuk vepron sipas kërkesës së Komisionit, kërkesa e tij refuzohet me vendim.
3. Komisioni refuzon kërkesën edhe në rastet kur ndaj aplikuesit ekzekutohet masa disiplinore e tërheqjes së përkohshme ose të përhershme të licencës ose fshirja e profesionistit shëndetësor nga regjistri.

#### Neni 32

##### E drejta në ankesë

1. Pala e pakënaqur me vendimin e komisionit për refuzimin e kërkesës për anëtarësim, licencim dhe Ri-licencim, ka të drejtë ankesë në afat prej 15 ditësh nga marrja e vendimit.
2. Ankesa i drejtohet Këshillit Drejtues të OFTK-së.
3. Këshilli Drejtues i OFTK-së është i obliguar që jo më vonë se 30 ditë nga pranimi i ankesës ta shqyrtojë atë.
4. Nëse Këshilli Drejtues e vendos se ankesa e tillë është e bazuar, merr vendim për licencimin e ankuesit, duke obliguar Komisionin për Licencim ta regjistrojë në regjistrin e lëshimit të licencave.

#### Neni 33

##### Lëshimi i licencës dhe faksimili

1. Licenca e OFTK-së – original lëshohet vetëm në një kopje.
2. Anëtari/ja pajiset me Licencën dhe faksimilin e tij/saj të punës në Zyret e Shërbimit Administrativ të OFTK-së, tërheqja e Licencës dhe faksimilit nga Zyret e OFTK-së bëhet vetëm nga titullari i/ tij
3. Licenca mund të përdoret vetëm nga fizioterapeuti titullar i licencës.
4. Një kopje e originalit të licencës së lëshuar ruhet në dosjen e aplikuesit.

Adresa: Kompleksi i Q.K.U.K, Klinika e Mjeksisë Fizikale me Rehabilitim, Kati i I-rë, RKS-10000.

Address: UCCK Complex, Physical Medicine Clinic with Rehabilitation, 1<sup>st</sup> Floor, RKS-10000.

Tel +383(0) 45 460 551; e-mail [info@oftk-ks.org](mailto:info@oftk-ks.org); web : [www.oftk-ks.org](http://www.oftk-ks.org)

Oda e  
Fizioterapeutëve  
të Kosovës







## Oda e Fizioterapeutëve të Kosovës / Komora Fizioterapeuta Kosova

### Kosovo Chamber of Physiotherapists

5. Vendimi i komisionit për miratimin e kërkesës, konsiderohet autorizim për kryetar/in e komisionit për nënshkrim të licencës.
6. Nënshkrimi i Kryetarit/es së Komisionit për Anëtarësim, Licencim dhe Ri-licencim konsiderohet rekomandim për Kryetar/in e OFTK-së për nënshkrimin e Licencës
  - 6.1. Licenca përmban të dhënat si:
    - 6.1.1. Emrin dhe Mbiemrin e titullarit të Licencës,
    - 6.1.2. Datën e lindjes së titullarit të Licencës,
    - 6.1.3. Vendi i lindjes,
    - 6.1.4. Numri personal i anëtarit/es
    - 6.1.5. Data e lëshimit të Diplomës
    - 6.1.6. Numri i Diplomës
    - 6.1.7. Numri i anëtarësisë së anëtarit/es
    - 6.1.8. Numri i licencës së anëtarit/es
    - 6.1.9. Data e licencimit dhe skadencës së licencësTë dhëna të tjera të cilat mund të plotësohen/ndryshohen sipas vendimit të Këshillit Drejtues të OFTK-së
7. Me rastin e lëshimit të licencës, të licencuarit i dorëzohet faksimili, i cili shërben si shenjë e identifikimit profesional.
8. Faksimili ka këtë përmbajtje:
  - 8.1. Logo Zyrtare e OFTK-së
  - 8.2. Thirrjen akademike
  - 8.3. Emrin dhe mbiemrin
  - 8.4. Thirrjen profesionale për të cilën është licencuar
  - 8.5. Numrin e Licencës
9. Fizioterapeuti aplikues sjell dëshmitë relevante për titujt për të cilët ka aplikuar për vendosje në faksimil si vendimin e noterizuar për caktimin e titullit akademik nga institucioni i akredituar arsimorë.
10. Madhësia dhe lloji i shkronjave në faksimil përcaktohen me vendim të Këshillit Drejtues të OFTK-së.
11. Pronari faksimilit është OFTK-ja dhe me rastin e skadimit të licencës, i licencuari është i obliguar që të dorëzojë faksimilin me rastin e dorëzimit të licencës së skaduar për të cilën është lëshuar faksimili i tillë.

#### Neni 34

#### Vlefshmëria kohore e licencës

1. Licenca e OFTK-së ndaj fizioterapeutëve të licencuar në OFTK lëshohet në afat prej 5 (pesë) viteve duke filluar nga data e vendimit të Komisionit për Licencim, përveç rasteve të parapara ndryshe me këtë Rregullore.

Adresa: Kompleksi i Q.K.U.K, Klinika e Mjekësisë Fizikale me Rehabilitim, Kati i I-rë, RKS-10000.

Address: UCCK Complex, Physical Medicine Clinic with Rehabilitation, 1<sup>st</sup> Floor, RKS-10000.

Tel +383(0) 45 460 551; e-mail [info@oftk-ks.org](mailto:info@oftk-ks.org); web : [www.oftk-ks.org](http://www.oftk-ks.org)

Oda e  
Fizioterapeutëve  
të Kosovës





## Oda e Fizioterapeutëve të Kosovës / Komora Fizioterapeuta Kosova

### Kosovo Chamber of Physiotherapists

- Në kuadër të procesit të Ri-licencimit ndaj anëtarëve të cilët vijojnë procedurat e Ri-licencimit në afat të rregullt Licencat e lëshuara nga OFTK, Licenca e punës lëshohet nga data e skadimit të Licencës paraprake me afat kohor të përcaktuar në paragrafin 1 të këtij Neni.
- Anëtari/ja i/e cili/a inicion procedurat e Ri-licencimit në afat jo të rregullt, rrjedhshmëria e afatit kohorë të licencës fillon nga data e mbajtjes së Komisionit.

#### Neni 35

#### Përmbajtja e licencës

- Licenca e lëshuar përmban këto të dhëna:
  - Pjesën hyrëse në të cilën shënohet baza juridike e lëshimit të licencës;
  - Emri dhe mbiemri i të licencuarit;
    - Thirrja profesionale, përfshirë këtu specializimin apo subspecializimin;
    - Data dhe vendi i lindjes;
    - Numri i diplomës dhe data e lëshimit të diplomës, apo certifikatës së specializimit
    - Numri i licencës;
      - Numrat e licencës harmonizohen me nr. E MSH.
    - Data e lëshimit dhe data e skadimit të licencës;
    - Numri personal;
    - Nënshkrimi i Kryetarit të Komisionit për Licencim dhe Kryetarit të OFTK-së;
    - Vula e OFTK-së e vendosur në mes të nënshkrimit të Kryetarit të Komisionit për Licencim dhe Kryetarit të OFTK-së.
  - Të dhënat në licencë shënohen në tri gjuhë: shqipe, serbe dhe angleze;
  - Kodi i licencës së specialistit është kodi i licencës së fizioterapeutit duke i shtuar edhe kodin e specializimit;
  - Licenca mund të nënshkruhet edhe nga personi i autorizuar nga Kryetari i Komisionit për Licencim ose Kryetari i OFTK-së.

#### Neni 36

#### Tërheqja e licencës

- Anëtari/ja njoftohet nga Oda për gatishmërinë e Licencës dhe të drejtën e tij/saj për tërheqje nga Zyret e Odës.
- Licenca tërhiqet vetëm personalisht nga titullari i licencës.
- Me rastin e tërheqjes i licencuari duhet të nënshkruhet në librin e tërheqjes së licencave.
- Në libër duhet të përmbajë:
  - Emrin dhe mbiemrin e të licencuarit;
  - Numrin e licencës;





## Oda e Fizioterapeutëve të Kosovës / Komora Fizioterapeuta Kosova

### Kosovo Chamber of Physiotherapists

- 4.3. Datën e tërheqjes së licencës;
  - 4.4. Nënshkrimin e titullarit të licencës.
5. OFTK lirohet nga përgjegjësia e ruajtjes së Licencës së Punës së anëtarit të cilat nuk tërhiqen brenda periudhës 6 mujore nga dita e njoftimit për gatishmërinë e saj për tërheqje. Në rast të humbjes së Licencës nga OFTK pas këtij afati anëtari mund të kërkojë vetëm dublikatën e licencës.

#### Neni 37

##### Licenca e dublikat

1. Komisioni për Anëtarësim, Licencim dhe Ri-licencim lejon lëshimin e Licencës së Punës në rastet e.
  - 1.1. humbjes së licencës;
  - 1.2. kërkesa e lëshimit të licencës dublikate të pa plastifikuara;
  - 1.3. raste të caktuara sipas nevojës me vendim të Këshillit Drejtues të OFTK-së.
2. Në rastet e humbjes së licencës, i licencuari njofton me shkrimin OFTK – për humbjen e saj, duke bashkangjitur vërtetimin e policisë.
3. Në rastet e kërkesës së Licencës së Punës të pa plastifikuara, anëtari duhet të njoftoj me shkrim OFTK dhe të parashtrij kërkesën drejtuar Komisionit për Anëtarësim, Licencim dhe Ri-licencim të OFTK-së.
4. Komisioni për Licencim verifikon dosjen e të licencuarit dhe vendos për kërkesën e tij.
5. Pagesa për licencë dublikate realizohet sipas Vendimit për taksa në fuqi nga OFTK.
6. Komisioni licencën e re e lëshon në datat e vlefshmërisë të licencës së humbur dhe në licencë shënohet **DUBLIKAT**.

#### Neni 38

##### Ndryshimi i te dhënave të Licencës.

1. Anëtari/ja ka të drejtë të kërkojë ndryshimin e te dhënave personale në Licencën e Punës të tij/saj duke adresuar kërkesë për ndryshim të te dhënave tek Shërbimi Administrativ i OFTK-së.
2. Shërbimi Administrativ në bazueshmëri të kërkesës dhe arsyës së anëtarit për ndryshim të te dhënave personale në Licencë, kërkon nga anëtari/ja dorëzimin e dokumenteve të nevojshme për prezantim tek Komisioni.
3. Licenca e lëshuar me te dhënat personale të ndryshuara lëshohet nga Komisioni për Anëtarësim, Licencim dhe Ri-licencim brenda afatit kohor të Licencës paraprake të anëtarit.





## Oda e Fizioterapeutëve të Kosovës / Komora Fizioterapeuta Kosova

### Kosovo Chamber of Physiotherapists

#### Neni 39

##### Faksimili i humbur apo dëmtuar

1. Në rastet e humbjes së faksimilit, i licencuari njofton me shkrimin OFTK – për humbjen e saj.
2. Shërbimi profesional verifikon dosjen e të licencuarit dhe vendos për kërkesën e tij.
3. Anëtari në kërkesën për faksimilen e ri, bashkangjet vërtetimin/dokumentin e policisë mbi paraqitjen e humbjes së faksimilet
4. Në rast dëmtimi të faksimilit, anëtari dorëzon faksimilen e dëmtuar në OFTK për vlerësim, pas së cilit vlerësohet nëse i njëjti do të pajiset me faksimil të ri.

#### Neni 40

##### Masa disiplinore e tërheqjes së përkohshme ose të përhershme të licencës ose fshirja e profesionistit shëndetësor nga regjistri

1. Komisioni i Anëtarësit, Licencimit dhe Ri-licencimit të OFTK-së është kompetent për tërheqjen e përkohshme ose të përhershme të licencës dhe fshirjen e profesionistëve shëndetësorë nga regjistri i anëtarëve.
2. Komisioni i Anëtarësit, Licencimit dhe Ri-licencimit të OFTK-së merr vendim për fshirjen nga regjistri i anëtarësisë i OFTK-së pas dërgimit të listës së anëtarëve të cilët nuk kanë kryer obligueshmërinë e pagesës ndaj OFTK-së nga Shërbimi Administrativ i OFTK-së.
3. Komisioni i Anëtarësit, Licencimit dhe Ri-licencimit të OFTK-së ekzekutimin e Masës disiplinore së tërheqjes së përkohshme ose të përhershme të licencës ose fshirja e profesionistit shëndetësor nga regjistri e bën në mbledhjen e parë të saj pas plotfuqishmërisë së vendimit të Këshillit Etik, ose vendimit të Gjyqit të Nderit në rast ankese nga pala me rastet e shkeljes etike nga Kodi Etik dhe Deontologjik i OFTK-së
4. Komisioni i Licencimit pas ekzekutimit e njofton organin kompetent se ka zbatuar këtë vendim, në mënyrë që organi kompetent të regjistrojë këtë masë në regjistrin e masave disiplinore të anëtarëve të Odës.

#### Neni 41

##### Publikimi i regjistrit të fizioterapeutëve të licencuar

1. OFTK do të publikojë çdo muaj listën më të re të fizioterapeutëve të licencuar në Web faqen zyrtare të OFTK-së.
2. Të dhënat e publikuara do të jenë:
  - 2.1. Emri dhe mbiemri,
  - 2.2. Numri i licencës,
  - 2.3. Data e lëshimit të licencës,
  - 2.4. Data e skadimit të licencës.

Adresa: Kompleksi i Q.K.U.K, Klinika e Mjeksisë Fizikale me Rehabilitim, Kati i I-rë, RKS-10000.

Address: UCCK Complex, Physical Medicine Clinic with Rehabilitation, 1<sup>st</sup> Floor, RKS-10000.

Tel +383(0) 45 460 551; e-mail [info@oftk-ks.org](mailto:info@oftk-ks.org); web : [www.oftk-ks.org](http://www.oftk-ks.org)

Oda e  
Fizioterapeutëve  
të Kosovës





## Oda e Fizioterapeutëve të Kosovës / Komora Fizioterapeuta Kosova

### Kosovo Chamber of Physiotherapists

#### Neni 42

##### Ri-licencimi i anëtarëve të pensionuar.

1. Anëtarët e OFTK-së të cilët arrijnë moshën 65 vjeçare me rastin e Ri-licencimit duhet të sjellin dëshminë-certifikatën mjekësore si kriter për Ri-licencimin e tyre.
2. Anëtarët e pensionuar lirohen nga obligimet për kryerjen e pagesave të taksave administrative për Shërbimet Administrative
3. Kohëzgjatja e licencës së tyre është 2 vjeçare, me lirim nga obligimi për arritjen e pikëve kredituese nga EVP.
4. Anëtari obligohet që për çdo 2 vite ne Zyret e OFTK-së të sjellë certifikatën mjekësore.

#### Neni 43

##### Taksat administrative

1. Në rastet e vonesave për ri-licencim sipas afatit të paraparë me Nenin 21 të kësaj rregullore, Komisioni për licencim do të aplikojë taksë shtesë për vonesë të përmbushjes së detyrimit. Në rastin e tillë, do të aplikohet taksa në lartësi prej 10 euro për çdo muaj vonesë nga data e skadimit të licencës
2. Taksa shtesë për vonesë sipas paragrafit 1 të këtij neni i shqiptohet aplikuesit për periudhë kohore nga skadimi i licencës deri në periudhën e ri-licencimit.
3. Në rastet e vonesave për pagesë të anëtarësisë nga afati i paraparë nga Neni 3 paragrafi IV i kësaj Rregulloreje anëtari obligohet të paguaj taksë shtesë për vonesë në lartësi prej 10 euro për çdo muaj vonesë nga afati i rregullt i pagesës së anëtarësisë
  - 3.1. Rrjedhshmëria e taksës shtesë për vonesë vazhdon deri në fillim të muajit Tetor, e finalizuar me fshirje të anëtarit nga anëtarësia e OFTK-së nëse anëtari deri në këtë afat nuk kryen obligimet e pagesës së anëtarësisë.
4. Anëtarit nuk i njihet e drejta e ankesës ndaj taksës shtesë për vonesë në anëtarësim dhe në rilicencim.
5. Taksat administrative caktohet në vendim të Kuvendit të OFTK-së.
6. Vendimi me të cilin është caktuar taksa administrative do të përmbahet sipas rregullave të procedurës së përgjithshme administrative përkitazi me përbarimin e akteve administrative.
7. Ndaj anëtarit të cili shqiptohet taksa për vonesë, taksa e tillë do të konfiguruar në regjistrat e OFTK-se dhe në profilin e anëtarit në Web faqen zyrtare të OFTK-së.





**Oda e Fizioterapeutëve të Kosovës / Komora Fizioterapeuta Kosova**  
**Kosovo Chamber of Physiotherapists**

**Neni 44**  
**Dispozitat përfundimtare**

1. Rastet të cilat nuk janë të parapara me këtë rregullore, vendosen nga Këshilli Drejtues i OFTK-së.
2. Me miratimin e kësaj rregullore shfuqizohet rregullorja paraprake për Anëtarësim Licencim dhe Ri-licencim të Fizioterapeutëve në OFTK.
3. Kjo Rregullore hyn në fuqi nga muaji Janar i vitit 2024.

Prishtinë, 22.12.2023

Kryetar i OFTK-së  
Ass MScI Feim Gashi PT





**Oda e Fizioterapeutëve të Kosovës / Komora Fizioterapeuta Kosova**  
**Kosovo Chamber of Physiotherapists**

**Kuvendi i Odës së Fizioterapeutëve të Kosovës**, në mbledhjen e rregullt të datës 22.12.2023 shqyrtoi propozim e Këshillit Drejtues për plotësim ndryshimin e Rregullores për Anëtarësim, Licencim dhe Ri-licencim të Fizioterapeutëve të OFTK-së të datës 29.11.2023 me numër Protokoli 518 dhe ne mbështetje të Nenit 19 paragrafi 1 në ndërlidhje me nënparagrafin 1.4 i LIGJI Nr. 04/L-150 PËR ODAT E PROFESIONISTËVE SHËNDETËSOR; Neni 20 paragrafi 4 i Statutit të Odës së Fizioterapeutëve të Kosovës mori këtë:

**V E N D I M**

- I. MIRATOHET propozimi për plotësim ndryshimit të Rregullores për Anëtarësim, Licencim dhe Ri-licencim të Fizioterapeutëve të OFTK-së nr.1024 të datës 20.12.2022.
- II. Rregullorja e theksuar në pikën e I-rë të këtij dispozitivi hyn në fuqi nga muaji Janar i vitit 2024.
- III. Vendimi u mor me shumicë votash të anëtarëve të Kuvendit të OFTK-së.
- IV. Ky vendim hyn në ditën e nënshkrimit.

**Arsyetim** – Anëtarët e Kuvendit të Odës së Fizioterapeutëve të Kosovës në mbledhjen e rregullt të mbajtur me datë 22.12.2023 në mbështetje të kompetencave të garantuara nga legjislacioni në fuqi votuan Propozimin për miratim të Rregullores për Anëtarësim, Licencim dhe Ri-licencim dhe me shumicë votash pro, 9 vota kundër dhe asnjë abstenim morën vendim sipas këtij dispozitiv.

T'i dërgohet

Anëtarëve të Komisionit të ALR të OFTK-së,  
Anëtarëve të Këshillit Drejtues të OFTK-së,  
Shërbimit Administrativ të OFTK-së.

**Prishtinë, 22.12.2023**

**Kryetar i Odës së Fizioterapeutëve të Kosovës**  
**Ass.MSci Feim Gashi PT**

Adresa: Kompleksi i Q.K.U.K, Klinika e Mjekësisë Fizikale me Rehabilitim, Kati i I-rë, RKS-10000.  
Address: UCCK Complex, Physical Medicine Clinic with Rehabilitation, 1<sup>st</sup> Floor, RKS-10000.  
Tel +383(0) 45 460 551; e-mail [info@oftk-ks.org](mailto:info@oftk-ks.org); web : [www.oftk-ks.org](http://www.oftk-ks.org)

**Oda e**  
**Fizioterapeutëve**  
**të Kosovës**

